



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.02.2018, ora 14:00

Drejtojnë mbledhjen:

Bledar Çuçi– kryetar **Oerd Bylykbashi** - kryetar

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve.
2. Miratimi i vendimit për ekspertë.
3. Miratimi i platformës së Komisionit.
4. Seancë dëgjimore me:
 - Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë
 - Komitetin Shqiptar të Helsinkit
 - Institutin Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Musa Ulqini, Gent Strazimiri, Enkelejd Alibeaj, Nasip Naço, Luan Rama, Nard Ndoka, Vangjel Dule, Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Dashamir Shehi.

Të ftuar:

1. Andi Murataj - koordinator i monitorimit të zgjedhjeve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
2. Kristaq Kume – Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor
3. Gerta Meta – Shoqata për Kulturë Demokratike, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
4. Premto Gogo – KRIIK Albania, Kualicioni i Vëzhguesve Vendorë
5. Rajmonda Prifti – Qendra për Gratë dhe Fëmijët, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e radhës të Komisionit *ad hoc* për Reformën Zgjedhore.

Dua t'ju vë në dijeni se kemi një sugjerim për prezencën e medias në përgjithësi në komision, për të cilin kemi rënë dakord paraprakisht. Kur kemi çështje të natyrës së produkteve që duhet të nxjerrim, pasi kemi marrë me konsensus një vendim të caktuar, ose do të zhvillojmë një seancë që lidhet më së shumti me ekspertizën, mendojmë që të mos i përfshijmë mediat në mbledhjen e komisionit, kurse në seancat e tjera apo pjesë të seancave që lidhen me transparencën, seancat dëgjimore apo pjesë të diskutimeve me natyrë më politike, mediat të jenë prezente.

Në këtë kontekst, në diskutimet që do të bëhen për tri çështjet e para të axhendës së ditës së sotme, mediat nuk do të jenë të pranishme në seancë, kurse në çështjen e katërt ato mund të jenë prezente.

Jemi dakord? Besoj se nuk ka ndonjë kundërshtim.

Atëherë, fillojmë me paraqitjen e rendit të ditës.

Mbledhja e sotme do të ketë këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve;
2. Miratimi i vendimit për ekspertë, kjo ka të bëjë më shumë me nominimin. Pra, herën e fundit miratuar një vendim në parim për ngritjen e grupit të ekspertëve dhe ramë dakord për numrin, kurse sot do të prezantohemi me emrat përkatës;
3. Miratimi i platformës së punës së Komisionit, mbi të cilën do të zhvillojmë të gjithë ecurinë e komisionit;
4. Seancë dëgjimore me:
 - Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë;
 - Komitetin Shqiptar të Helsinkit;
 - Institutin Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor.

Këto janë tri nga organizatat, OJF-të, që objektin e tyre e kanë të lidhur ngushtë me zgjedhjet. Kështu, fillojmë pjesën e seancave dëgjimore me të gjitha institucionet publike dhe shoqërinë civile.

Jemi dakord me rendin e ditës?

Nasip Naço – Faleminderit!

Për sa u përket ekspertëve të LSI-së, në vend të Ornela Mahametaj do të jetë Ilirian Muho.

Bledar Çuçi – Dakord. E zëvendësojmë kur të shkojmë te pika përkatëse.

Për sa i përket pikës së parë, procesverbalet janë dërguar me *e-mail* nga sekretaria e komisionit në adresat e gjithsecilit. Ka ndonjë vërejtje për procesverbalet e mbledhjeve të fundit? Nuk ka.

Pika e dytë ka të bëjë me nominimin e ekspertëve.

Po ju lexoj listën me emrat e ekspertëve që janë propozuar nga anëtarët e Komisionit Zgjedhor.

Ata janë:

Elion Semanaj nga Partia Socialiste;

Gedian Llatja nga Partia Socialiste;

Eridian Saliari nga Partia Socialiste;

Alban Dokushi nga Partia Socialiste;

Ivi Kaso nga Partia Demokratike;

Dorian Gjomarkaj nga Partia Demokratike;

Në vend të zonjës Ornela Muhametaj nga Lëvizja Socialiste për Integrim, është vendosur Ilirian Muho;

Arian Madhi nga Partia Republikane.

Pra, këta janë emrat e ekspertëve që do të asistojnë Komisionin e Reformës Zgjedhore.

Besoj se nuk ka ndonjë kundërshtim apo sugjerim tjetër. Kështu që, miratohet lista nominale.

Oerd Bylykbashi – Përpara se të kalojmë te pika e tretë, propozoj që grupi i ekspertëve të komisionit të na përgatisë një tabelë, ku të ketë kategorizuar rekomandimet e të tri raporteve të *OSBE-ODIHR*-it sipas fushave që trajtojnë: media, fushata, administrata, procesi ankimor e me radhë.

Një pjesë e mirë prej jush e njuh këtë kërkesë të komisionit, sepse edhe në komisionin e shkuar ishte lënë e njëjta detyrë. Është një dokument që do të na ndihmojë ne për të organizuar më mirë punën për të ndjekur trajtimin e rekomandimeve.

Një rekomandim mund të zërë vend në më shumë se një fushë specifike, për shkak se mund të prek më shumë se një çështje. Kështu që, në koordinim me njëri-tjetrin, përgatiteni këtë dokument. Ndoshta mund të shfrytëzoni edhe punën e bërë në vitin 2016.

Jemi dakord që t'i lëmë këtë detyrë grupit të ekspertëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa kohë mund t'ju duhet për ta përgatitur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Mbledhjen e ardhshme do ta vendosim ne, por, megjithatë, pasi ta bëni gati, rakordojuni me sekretarinë në mënyrë që dokumenti t'u shpërndahet elektronikisht të gjithë anëtarëve, kurse në mbledhjen tjetër diskutojmë për plotësime.

Pika e tretë e axhendës është miratimi i platformës së komisionit. Komisioni gjendet përballë nevojës dhe detyrës për të trajtuar tri raporte të OSBE-ODIHR-it. Kjo do thotë se ngarkesa është e konsiderueshme. Një numër rekomandimesh përsërisin veten ose janë të grupueshme, pra, nuk është thjesht një shumatore, por tematikat janë të konsiderueshme.

Në koordinim me bashkëkryetarin Çuçi, do ju prezantojmë një dokument, i cili përfshin pesë çështje kryesore dhe prioritare (ka edhe çështje të tjera kryesore, që për momentin ndoshta nuk janë të përfshira, por ky dokument është i hapur për t'i përfshirë), të cilat kanë dy aspekte. Pra, përveç aspektin prioritar kanë edhe një aspekt tjetër. Shpeshherë, pothuajse të gjitha përfshijnë më shumë se një rekomandim. Kërkojnë punë të fokusuar nga komisioni në nivelin politik, në nivelin e grupit të ekspertëve apo edhe të asistencës dhe ekspertizës ndërkombëtare, që ne do të marrim.

Duke i grupuar në këtë formë, arrijmë t'i koncentrojmë dhe vëmë në lëvizje në mënyrë paralele. Për sa i përket shpejtësisë, ato do të marrin kohën e vet, sepse mund të dalin problematika të ndryshme, por na jepet mundësia neve si komision t'i ndjekim më mirë.

Sugjeroj që të caktohen anëtarë nga të dy krahët për të ndjekur si po trajtohen çështje specifike, por këtë do ta diskutojmë në një moment tjetër.

Ky dokument përfshin pesë çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me votimin elektronik. Ai përfshin aspektin e identifikimit biometrik, votimit elektronik dhe numërimit elektronik. Kjo është një temë, e cila trajton disa problematika, ndërthuret me disa pjesë të procesit zgjedhor, kërkon një këndvështrim 360 gradë dhe një ekspertizë shumë të mirë qoftë brenda apo edhe jashtë Shqipërisë. Për rrjedhojë, e grupuar së bashku, do të na japë mundësinë që të mos lëmë gjëra jashtë.

Do të trajtojë probleme në qendrën e votimit, probleme të numërimit, të transmetimit të rezultatit, të profesionalizimit të administratës, eventualisht të reduktimit të administratës, por do të na ndihmojë shumë për të luftuar krimin zgjedhor, duke frenuar fenomene negative siç është marrja e kartave të identitetit, shitblerja e votës, votimi në emër të personave të tjerë përfshirë emigrantët, mbushja e kutive të votimit e të tjera. Pra, fenomene që ndodhin si brenda qendrës së votimit, ashtu edhe jashtë saj.

Kjo është një tematikë e madhe, prioritare, e cila kërkon një kohë të caktuar për marrjen e opinionit të kompanive të specializuara për zgjedhjen e modelit dhe për ecjen përpara.

Çështja e dytë ka të bëjë me votimin e emigrantëve. Edhe kjo çështje ka të njëjtin aspekt. Është një çështje shumë e madhe me kompleksitet në të gjitha aspektet, duke filluar nga aspekti kushtetues deri tek aspektet logjistike specifike, që duhen për të realizuar me sukses këtë proces. Numri i emigrantëve tanë është rreth 1,5-1,7 milionë, nuk e kemi informacionin e saktë për këtë, dhe një pjesë e madhe e tyre gëzojnë të drejtën e votës.

Për rrjedhojë, sa i përket votës së tyre dhe që zgjedhjet të jenë të sigurta, volumi i punës do të jetë shumë i madh. Kërkohet ekspertizë ndërkombëtare, konsultime me praktikant më të mira, punë konkrete për hartimin e një politike dhe draftimi përkatës.

Çështja tjetër ka të bëjë me fushatën, kjo e ndarë në disa elemente më specifike. Rregullat e fushatës duhen përmirësuar, rishikuar dhe përditësuar në raport me zhvillimet e fushatave në 15 vjetët e fundit, që kur është hartuar pjesa më e madhe e dispozitave.

Media në fushatë. Si e mbulon media fushatën zgjedhore. Rregullat për median. Ne kemi një kapitull, që vendos si parim të rëndësishëm kohën e barabartë midis palëve. Kjo e ndarë në nivele të ndryshme në varësi edhe të peshës që kanë subjektet zgjedhore në elektorat. Sot, peizazhi i medias elektronike është shumë herë më i zhvilluar sesa në vitet 2002-2003 kur janë hartuar dispozitat ekzistuese. Pra, është e nevojshme të shtrëngohet fort në mënyrë që të ketë një zbatim efikas të konceptit të barazisë në periudhën e fushatës zgjedhore.

Financimi politik do të përfshijë financimin në fushatë zgjedhore, por edhe atë jashtë fushatës zgjedhore. Na duhet një qasje 360 gradë. Deri më sot ka punë të bërë nga organizata ndërkombëtare, në mënyrë specifike nga Këshilli i Europës, nëpërmjet ekspertëve dhe projekteve. E gjithë kjo ekspertizë, tashmë do të futet në hullinë e punës së komisionit. Midis tyre ka çështje që kryqëzojnë. Financimi kryqëzohet me median, sepse një pjesë e madhe e financimit shpenzohet për mbulimin mediatik.

Pra, vënia së bashku na ndihmon që të mos lëmë gjëra të pambuluara në raport me njëra-tjetrën.

Pika e katërt e çështjes së fushatës janë burimet shtetërore. Praktishtë, në një rekomandim prioritar, rekomandimi nr. 3, ODIHR-i ka përcaktuar çështjen e abuzimit me burimet shtetërore dhe presioni që bëhet mbi administratën. Kështu që, kjo është një çështje e rëndësishme për t'u diskutuar. Këtu kemi nevojë për praktika të mira ndërkombëtare për të parë se cilat janë zgjedhjet më efektive. Relativisht jemi pak të zhvilluar në këtë aspekt. Për sa

u përket rregullave, ato janë të pjesshme, të pakoordinuara dhe na duhet ta rishikojmë globalisht.

Çështja e katërt e madhe për diskutim janë votuesit, zgjedhësit dhe regjistrimi i tyre jo thjesht në listë, por aty ku ata jetojnë. Pra, merr rëndësi të madhe vendbanimi e për rrjedhojë edhe regjistri i adresave.

Është një çështje, që, në fakt, pati një zgjidhje të rëndësishme, domethënë nga viti 2005 me një projekt specifik. Më pas, projekti i madh i modernizimit të gjendjes civile, 2007-2009, ku zgjidhnim edhe identifikimin e zgjedhësve.

Sot kemi një problem të madh, që zgjedhësit nuk kanë adresë të qartë. Historia e 999-ve apo 000-ve është duke u përkeqësuar. Kemi të dhëna të provuara që zgjedhësit zhvendosen fiktivisht nga një zonë në një tjetër. Kemi nevojë të rikopsisim fort këtë gur themeli që ka procesi zgjedhor. Eksperienca është, por duhet të bëjmë ekspertizën, që të shtrëngohet mirë ky aspekt i rëndësishëm. Të mos harrojmë se problemet e listës së zgjedhësve në të shkuarën kanë qenë çështje politikash të vazhdueshme paszgjedhore.

Çështja e fundit në listë është ajo e administratës zgjedhore, por lista është e hapur. Administrata zgjedhore sot, pas një anshmërie të dukshme politike në vitet 2000-2003, ku në vitin 2003 u balancua politikisht, mbi bazën e formulimit të ODIHR-it dhe të nevojës... Ndërkohë, është e nevojshme të mbahet kontrolli politik për të pasur besueshmëri.

Nga ana tjetër, duhet të shikojmë rrugët për të shkuar drejt profesionalizimit, ashtu siç e bën të qartë në një tryezë të fundit përfaqësuesit e OSBE-ODIHR-it, se profesionalizmi dhe emërimi politik nuk janë inkompatibël. Ne duhet të gjejmë një zgjidhje, që të na japë mundësinë të kemi një administratë profesionale, ndërkohë që ruan besimin e palëve në proces.

Për këto pesë çështjet ne kemi menduar se kërkojnë një volum të madh pune të përqendruar në fushat përkatëse.

Për dy çështjet e para kemi menduar se është e nevojshme të bëhet një *research* për praktikën, dokumentet dhe standardet që ekzistojnë. Më pas kjo do të na çojë drejt një *workshop*-i, jo thjesht konferenca të përgjithshme, por seminare specifike që çojnë drejt zgjidhjesh. Dokumenti i prodhuar do të kalojë në komision ose komisioni do të jetë pjesë e procesit të miratimit të dokumentit dhe më pas do të bëhet draftimi i zgjedhjeve teknike. Kjo do të kërkojë përfshirjen e grupit të ekspertëve të komisionit dhe ekspertëve të tjerë, kryesisht ndërkombëtarë, që do të na japin zgjidhje më të mira. Kjo gjë është e vlefshme, për çështjen e parë dhe të dytë, por edhe për çështjet e tjera.

Gjykojmë se formatimi i secilës prej pesë çështjeve me një tipologji pak a shumë standarde do ta ndihmojë komisionin të punojë me fokus të qartë, ta ndjekë në mënyrë të qartë dhe të garantojë rezultat brenda afateve që janë relativisht të ngushta për këtë punë.

Ky ishte prezantimi i pesë çështjeve. Siç e thashë, anëtarët e komisionit kanë të drejtë të propozojnë çështje të tjera. Mund të përfshihet për diskutim çështja e sistemit zgjedhor dhe duhet të caktojmë kohën e duhur. Po ashtu, edhe çështjet e referendumeve, që janë të patrajuara që prej vitit 2000.

Në emër të opozitës, jo vetëm për shkak të rekomandimit nr. 2 të OSBE-ODIHR-it, rekomandimi i dytë prioritar apo rekomandimi i parë në substancë prioritare, bazuar në faktin që çështja e shit-blerjes së votës dhe masat për luftën ndaj shit blerjes së votës u bënë dje pjesë e deklaratës së delegacionit të Parlamentit Europian dhe parlamentit të Shqipërisë, do të propozoj të shtohet një pikë tjetër si kjo, të jenë gjashtë çështje. Përveç ekspertizës, do të na duhet edhe praktika e mirë ndërkombëtare, si e kanë nxitur vende të tjera.

Do të jetë një çështje që do të ketë prerje me tema të tjera, me votim elektronik, me fushatë, me aspekte të ndryshme, por mund të dalin edhe jashtë, siç mund të jetë nevoja për të riparë aspektin e Kodit Penal apo legjislacion tjetër, që është rrotull kësaj. Unë propozoj të futet nëse ka dakordësi. Do ta riformulojmë me tipologji dhe standardet e çështjeve të tjera. Do të bëhen gjashtë çështje kryesore për trajtim nga komisioni.

Ky ishte prezantimi.

Kolegë, fjala është për ju, për të sugjeruar, për të bërë vlerësim apo për të shtuar çështje të tjera,

(Diskutime pa mikrofon.)

Bledar Çuçi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E shikoj që nuk e konkurroj dot 14 shkurtin.

Dokumenti mbetet i hapur për mbledhje të tjera.

Nëse doni të diskutojmë çështje të tjera të natyrës më politike, që lidhen me sistemin, mund t'i fusim në axhendë dhe në proces gjatë kohës që kemi komisione. Gjithsesi, dokumenti është dinamik, por ne sot i miratojmë, që të fillojmë punën me çështjet që sapo tha edhe zoti Bylykbashi.

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Kam një propozim për bashkëkryetarët.

Mendoj se platforma që paraqiti njëri nga bashkëkryetarët duhet zgjidhur me matricën e ekspertëve me një kalendar veprimesh me afate konkrete. Nëse do të ngelim në kuadrin e

përgjithshëm të këtyre pesë, gjashtë apo shtatë pikave, mendoj se do të kemi një sorollatje, nëse do ta vëmë punën përpara, për ta zgjidhur dhe për të marrë përgjigje definitive dhe më pas t'i fusim në Kodin Zgjedhor, duhet të bëhet një ndërthurje e matricës së ekspertëve në draftin që kaluam sot, të cilin mendoj ta kalojmë në parim, por javën tjetër ose për 10 ditë duhet të vijë e shkruar bashkë me matricën e ekspertëve, që të kemi mundësi të punojmë për çështje të caktuara. Meqenëse jemi shumë anëtarë komisioni, mund të ndahemi në sensin e grupeve të caktuara për çështje të caktuara bashkë me ekspertët, për të dhënë mendime, për të paraqitur një draft dhe më pas të vendoset si do të votohet.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Fino!

Ndërhyrja juaj ishte me shumë vend.

Më lejoni t'ju njoftoj për bisedimet që kemi pasur me partnerët tanë dhe organizatat ndërkombëtare, që asistojnë Shqipërinë, në këtë fushë për gatishmërinë që kanë treguar për të asistuar në këtë komision me produkte dhe ekspertë konkretë të fushave dhe çështjeve të caktuara.

Po ta shikojnë me kujdes dokumentin, ai përmban një përshkrim të veprimeve që duhet të bëjmë për secilën çështje. Ajo që i mungon dokumentit dhe që ne do t'i plotësojmë me ekspertët, por edhe me partnerët, në varësi të gatishmërisë që do të tregojnë, është kolona e fundit që kemi lënë pa plotësuar, pjesa kohore. Nuk e kemi lënë pa qëllim, sepse duhet të koordinojmë të gjitha burimet që kemi në dispozicion, jo vetëm ekspertët që kemi në komision, që do të rishikojnë çdo gjë para se të marrin një vendim, por edhe me ata që do të na furnizojnë me praktikën më të mirë, me studime, me *research*-e, veprime që i ka përcaktuar edhe dokumenti që sapo miratuam.

Besoj se shumë shpejt ne do të vendosim një kalendar të të gjitha çështjeve që përmendëm dhe miratuam sot në platformë, e koordinuar kjo me donatorët dhe partnerët tanë, që asistojnë në këtë pikë. Besoj se kjo është forma më e mirë dhe pasi të miratojmë, unë dhe kolegët e opozitës gjykojmë me vend sugjerimin e zotit Fino, që për çështje të caktuara mund të lëmë një pjesë të komisionit për t'u marrë në mënyrë paralele, meqenëse kemi shumë çështje, që të mos angazhohet i gjithë komisioni me të gjitha çështjet dhe pastaj, në fund fare i agregojmë dhe i miratojmë këtu në komision.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Duke vijuar atë që tha zoti Fino, përveç matricës që do të përgatisin ekspertët, ne mund të shtojmë edhe një kolonë të ky dokument, ku të vendosim se cilat mund të jenë ato rekomandime që mund të trajtohen nga këto fusha. Pra edhe kjo bën një

lloj sinergjie mes dy dokumenteve. Sigurisht matrica mund të na nxjerrë ndonjë çështje shtesë për ta organizuar në një këndvështrim tjetër, kështu që besoj se biem dakord për këtë.

Fatmir Mediu – Kjo është një ide se çfarë do të bëjmë, por që të kthehet në matricë duhet edhe një afat kohor, që u duhet lënë ekspertëve dhe personave përgjegjës. Do të ishte shumë e rëndësishme që të paracaktojmë disa afate kohore, në mënyrë që të jemi më racionalë dhe të dimë si të gjykojmë në kohë për të arritur në përfundime sa më të drejta.

Bledar Çuçi – Shumë dakord, ai është hapi dhe ndoshta tek ajo që tha zoti Bylykbashi (e kam për ekspertët tani), te matrica, pra kolonën që do të shtojmë, bëhet vetëm referenca te rekomandimet apo relevanca që ka me rekomandim të caktuar te një nga të tri raportet, apo tek të tria, me rekomandimet e ODIHR-it. Pra ta shtojmë një kolonë atje. Këto çështje që do të trajtojmë me këto veprime lidhen me rekomandimin nr. 3 apo nr. 2 të ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 2017 apo 2015. E kuptoj që pjesa e parë që do të bëni është më e plotë se kjo, por ta vëmë në matricë meqë do ta kemi si dokument pune, duke i shtuar afatet kohore për çdo veprim që do të bëjmë, në mënyrë që të jemi të qartë si *road map* se deri në çfarë date do të mundemi që, në bazë të gjithë kësaj ekspertize, të marrim vendimin e caktuar për çështje të caktuara. Të jetë edhe pjesa e relevancës apo referenca te rekomandimi i OSBE/ODIHR-i!

Oerd Bylykbashi – Duke qenë se ramë dakord për këtë dokument, kjo na hap rrugën edhe në bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë pikë, do të doja t'ju informoja që, në cilësinë e bashkëkryetarëve, i kemi kërkuar nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit, asistencën me ekspertizë OSBE/ODHIR-it nëpërmjet zyrës së saj në Tiranë dhe Komisionit të Venecias, përmes zyrës së KiE-së në Tiranë. Janë dy autoritete të padiskutueshme, të cilët punojnë në mënyrë të përbashkët dhe vlerësimet e Kodit Zgjedhor i bëjnë bashkë. Në të kaluarën ata na kanë asistuar me ekspertizë të jashtëzakonshme për fazën e draftimit, si dhe me raporte të përbashkëta pasi kodi është miratuar.

Nëse koha do të na premtojë, do t'i kërkojmë paraprakisht një vlerësim të përbashkët Komisionit të Venecias dhe OSBE-ODIHR-it për kodin në versionin e pamiraturar ende. Kjo do të na ndihmonte në solidaritetin e dokumentit. Përveç këtyre dy institucioneve, kemi kërkuar zyrtarisht asistencën e BE-së, qoftë në mbështetje financiare qoftë në koordinim me partnerët e tjerë për ekspertizë ndërkombëtare për aktivitetet që kemi parashikuar.

Ky ishte një informacion në lidhje me këtë çështje, sigurisht që do ta detajojmë edhe më tej pas dakordësisë për planin e punës së ditës së sotme.

Unë ju falënderoj shumë, sepse besoj që miratimi i planit të punës së komisionit, do të na japë mundësinë të ecim në mënyrë të organizuar për të gjitha këto çështje! Duke qenë se i trajtuam këto çështje shumë të rëndësishme, kalojmë te pika 4.

Sot është fillimi i procesit të konsultimit publik që do të bëjë komisioni me organizata, dhe jo vetëm, të cilat kanë një eksperiencë dhe ekspertizë në fushën e zgjedhjeve. Kjo pjesë do të jetë edhe publike, prandaj le të thërrasim median.

Të bëjmë 5 minuta pushim sa të hyjë media dhe vazhdojmë me tej!

(Pas pushimit)

Fillojmë me pikën 4 të rendit të ditës, që është seancë dëgjimore me organizatat e shoqërisë civile, të cilat kanë eksperiencë ose ekspertizë, apo të dyja bashkë, në procesin zgjedhor dhe që kanë treguar interes të vazhdueshëm në procesin zgjedhor me angazhim aktiv, qoftë në vëzhgim, qoftë me propozime në periudhën e zgjedhjeve, në periudhën jashtë zgjedhjeve dhe gjatë reformave zgjedhore.

Komisionit, në këtë kohë, përfshirë kërkesat e bëra më herët, gjatë viteve 2016-2017, i kanë ardhur një seri propozimesh e kërkesash nga një numër organizatash, të cilat mbulojnë tërësisht aspektin zgjedhor apo që kanë interes për çështje të caktuara të procesit. Sigurisht lista është më e gjatë dhe ne kemi menduar që ta ndajmë në grupe organizatash.

Kam edhe diçka tjetër në parim, para se të vazhdojmë me detajet. Këto seanca dëgjimore që po planifikojmë me organizatat e shoqërisë civile, më pas do të kemi seanca dëgjimore edhe me institucione shtetërore të përfshira në procesin zgjedhor, janë në kuadrin e konsultimit publik që bën Komisioni i Reformës Zgjedhore jo vetëm me aktorë të interesuar, që kanë për të thënë dhe mund të bëjnë propozime për këtë proces, por edhe me opinionin publik, që të dëgjojnë se cili është diskutimi, që do të kemi nga ky ndërveprim. Siç e thamë, do të jenë seanca publike dhe të hapura për median.

Sot kemi çmuar të thërrasim në seancë dëgjimore tri organizata, Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë, i cili përfshin disa organizata tashmë me eksperiencë të madhe. Është ai që bën vazhdimisht një raportim të konsoliduar sipas standardit të raportit të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet, e për rrjedhojë, ka bagazh të rëndësishëm në këtë fushë. Po kështu është edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili në mënyrë të veçantë ka ndjekur gjatë viteve proceset zgjedhore dhe ka bërë vazhdimisht rekomandime specifike, si dhe Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor, gjithashtu një nga aktorët më të hershëm në organizimin e shoqërisë civile në raport me vëzhgimin e zgjedhjeve, me propozime dhe ekspertizë.

Sot unë shoh përfaqësuesit e tri organizatave, dhe i falënderoj që iu përgjigjën ftesës sonë!

Do ta organizojmë në mënyrë të tillë:

Secila organizatë do të ketë 20 minuta kohë në dispozicion për të bërë prezantimin e problematikave dhe rekomandimeve që ka.

Ju ftoj të jemi sa më efikasë në punën tonë. Ju keni mundësinë të na sillni dokumentacion të shkruar rishtas, apo materiale më të hershme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Maksimumi 20 minuta, por konsultimi me ju nuk mbyllet këtu, sepse do të kemi tryeza, *workshop*-e dhe konferenca në kuadër të metodologjisë së punës që u miratua sot nga komisioni, ku ju do të jeni të ftuar të kontribuoni në evente të hapura për publikun, ashtu siç do të kemi mundësinë të shkëmbejmë në vijim. Pra, secili prej jush do të ketë 20 minuta në dispozicion për të bërë prezantimin e problematikave.

Fillojmë me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë. Besoj se do të caktoni një përfaqësues! Kush do ta bëjë prezantimin?

Gerta Meta – Përshëndetje!

Ne do të jemi shumë rigorozë dhe koncizë sipas sugjerimeve tuaja.

Oerd Bylykbashi – Prezantimi, për efekt të zbardhjes në procesverbal...

Gerta Meta – Do ta ndajmë prezantimin shumë shkurt mes meje dhe kolegut tim. Premto në lidhje me ato që ne sjellim si shqetësim.

Oerd Bylykbashi – Të prezantohet secili me emrin e vet!

Ne ju njohim, por për efekt të publikut, thoni emrat!

Gerta Meta – Faleminderit shumë për ftesën!

Unë jam Gerta Meta, një nga anëtarët e Komitetit Drejtues të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë. Natyrisht, na vjen mirë kur dëgjojmë vlerësime konkrete nga bashkëkryetarët, por besoj edhe nga anëtarët e Komisionit për Reformën Zgjedhore, në lidhje me veprimtarinë dhe fokusin që kemi ne, si koalicion, sidomos për problematikat zgjedhore në Shqipëri.

Së pari, ju falënderojmë shumë për vëmendjen dhe për ftesën në këtë dëgjese publike dhe ndihem shumë mirë me këtë pozicion, këtë lloj përballje dhe bisede, duke parë që në fokus është shqetësimi dhe merakun për procesin zgjedhor në Shqipëri, i cili është dypalësh!

Gjithashtu falënderoj Komisionin për Reformën Zgjedhore që në mbledhjen e tij të dytë ka arritur të gjej konsensusin dhe gjuhën e përbashkët e të dyja palëve, maxhoranca dhe opozita, për të shprehur këtë lloj konsiderate në lidhje me çfarë do të shprehim ne dhe çfarë

shqetësimesh sjellin qytetarët për realizimin e proceseve zgjedhore, se cili do të jetë integriteti i proceseve zgjedhore në vazhdim dhe jo vetëm i një procesi.

Na vjen mirë që ky komision ka disa piketa konkrete, që i kemi kërkuar vazhdimisht, pra cila do të jetë rregullorja e brendshme dhe se cili do të jetë plani i punës. Ne sapo dëgjuam që realisht këto dy lloj platformash janë në vëmendjen e Komisionit për Reformën Zgjedhore. Në vazhdim do të jenë edhe dokumentet, që besoj se do të na shpërndahen edhe neve, si aktorë të shoqërisë civile apo si përfaqësues të koalicionit. Ju e dini që ne kemi qenë ndër aktorët më aktivë, që kanë sjellë vazhdimisht pranë Komisionit për Reformën Zgjedhore piketa dhe rekomandime konkrete, sugjerime dhe të gjithë problematikën e zgjedhjeve e proceseve zgjedhore në vite, që nga viti 1992, me fokusin për ta ndihmuar punën e Komisionit për Reformën Zgjedhore, që të mbajë parasysh se çfarë duhet të ketë në platformën dhe në ecurinë e punës së tij për të qenë shumë efikas dhe shumë i suksesshëm.

Me thënë të drejtën, nga eksperiencia e vitit të shkuar, ne kemi qenë ndër aktorët që kemi thënë se Komisioni për Reformën Zgjedhore, për mungesë të vullnetit, shkoi në një dështim total të mosgjatjes së këtij konsensusi politik për ta realizuar përfundimisht reformën zgjedhore në Shqipëri.

Mendoj se kemi eksperiencia pozitive dhe kemi një mesazh pozitiv që maxhoranca dhe opozita do të vazhdojnë të jenë bashkë në të gjithë ecurinë derisa të realizohet përfundimisht ky fokus dhe qëllim që ka Komisioni i Reformës Zgjedhore.

Ne, si aktorë të shoqërisë civile dhe si përfaqësues të interesave të qytetarëve dhe votuesve shqiptarë kemi një merak: në fund, qytetarët të dinë se do të ketë një vullnet politik për të gjitha prioritetet dhe çështjet madhore, qoftë edhe për 5 çështjet që dëgjuam nga një prej bashkëkryetarëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore, po flas për një dokument që ne e mirëpresim. Për të ndihmuar njeri-tjetrin dhe për të qenë më konkretë, do të ishte mirë që ky dokument të vihej në dispozicion sa më shpejt, me qëllim që edhe në të jemi sa më konkretë, të mos vijmë me gjëra të përgjithshme e të bëjmë atë qokën sikur dëgjojmë njëri-tjetrin. Në të gjitha ato prioritete secili nga aktorët e shoqërisë civile duhet të japë rekomandime konkrete, që, me vullnetin e të dyja palëve, të realizohet qëllimi i reformës zgjedhore.

Oerd Bylykbashi – Zonja Meta, së pari, dokumenti që aprovaam sot është shumë i rëndësishëm, do t'ju shpërndahet dhe do të bëhet publik dhe ajo që thatë në fund, do të jetë pjesë e ndërveprimit tonë të mëtejshëm mbi bazën e atij dokumenti pune. Por sot ne kërkojmë të dimë se cilat janë shqetësimet tuaja për procesin zgjedhor, ndërkohë askush nuk mund ta

paragjykojë këtë komision për mënyrën si do të veprojë. Eksperiencia e parlamentit tregon se komisionet kanë funksionuar, ai është një përjashtim dhe urojmë që do të punojmë më tutje.

Ju lutem, të shfrytëzojmë kohën maksimalisht!

Greta Meta – Na vjen mirë që sot edhe ne jemi në unison me disa kërkesa konkrete në lidhje me punën e Komisionit për Reformën Zgjedhore. Ne e kemi sjellë pranë Kuvendit dhe besoj se kjo kërkesë dërguar posaçërisht Komisionit për Reformën Zgjedhore dhe aktorëve me të rëndësishëm të institucioneve që merren me menaxhimin e proceseve zgjedhore në Shqipëri do të jetë protokolluar. Për të pasur një lloj aksesit dhe për të kuptuar se cilat janë kërkesat tona për komisionin dhe disa sugjerime konkrete për punën e komisionit, unë do t'ia kaloj fjalën kolegut tim, zotit Premto.

Premto Gogo – Ju faleminderit!

Unë quhem Premto Gogo dhe jam një nga anëtarët drejtues të Komitetit Drejtues të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, i cili ka një eksperiencë të gjatë dhe ndryshe nga disa aktorë të tjerë, që e ndjekin në mënyrë specifike ose në fusha të veçanta tërësinë e elementeve që përbëjnë procesin zgjedhor. Koalicioni, edhe për hir të mënyrës si është strukturuar (në më shumë se 30 organizata në të gjithë vendin), ka specifika të ndryshme në fushën e të drejtave të njeriut dhe të demokracisë, e sheh procesin zgjedhor në tërësinë e elementeve të tij, duke synuar të ketë një integritet të procesit zgjedhor, pra jo thjesht një proces zgjedhor dhe një fitues, por duke filluar me të gjithë aktorët e përfshirë dhe legjitimitetin e rezultatit që sjell. Ndryshe nga komisionet e mëparshme që kemi ndjekur, këtë radhë kemi menduar të ecim me hapin e komisionit, jo se koalicioni ka ndenjur në heshtje, por nisur nga zhvillimet kontestuale, ka protokolluar një kërkesë rreth së cilës përmbledhet edhe ajo që do të nënvijëzohet më pas dhe që lidhet me dy drejtime: me veprimtarinë e komisionit, nisur nga eksperiencia e pasur dhe pritshmëritë, që ne, si aktorë të shoqërisë civile kemi, nisur edhe nga deklaratat e krerëve politikë për nevojën dhe thellësinë e prekjes së kuadrit ligjor zgjedhor, për të pasur një proces gjithëpërfshirës (ndryshe nga komisionet e tjera), me dhe disa problematika kryesore që mendojmë se mund të përfshihen në planin e punës së komisionit.

Në lidhje me veprimtarinë e komisionit ne rekomandojmë që të bëhet një miratim i një akti rregullues ose i një rregulloreje të veçantë. Në fakt, është një kërkesë e përsëritur që nga komisioni i vjetshëm, nuk e bëjmë për herë të parë dhe, nisur nga procesverbalet e komisioneve të mëparshme, e kanë kërkuar edhe anëtarët e komisionit të mëparshëm.

Përgjigjja e dhënë se mjaftuaka Rregullorja e Brendshme e Kuvendit apo për komisionet e tjera, nuk është e mjaftueshme, sepse ka disa mangësi, si për shembull: dokumentacioni, zbardhjet e kontributeve nga aktorët vendas dhe të huaj dhe diskutimet në

seancë. Të gjitha këto kërkojnë një dinamikë tjetër dhe mendojmë se kjo do të realizojë marrëdhënien me aktorët që kontribuojnë në proces.

Së dyti, është hartimi i planit të punës, që u miratua për të cilin shprehim konsideratën tonë. Mendojmë se partitë politike duhet të kenë një qasje politike për çështjet që duhet të trajtohen nga ky komision, pra mbi atë se sa duhet të zgjerohet fokusi i punës së këtij komisioni dhe sa do të jetë thellësia e ndërhyrjes në të. Më pas, në varësi të planit të punës, mbi të cilin do të materializohen këto qëndrime e vullnete politike, ne si Koalicion i Vëzhguesve Vendorë, duke qenë se kemi një tërësi të madhe rekomandimesh për çdo aspekt, nga më elementaret, deri te më thelbësoret (nuk mjafton as dy orë as një ditë e tërë), do të ofrojmë kontributet tona të detajuara.

Së treti, po prapë lidhur me natyrën e punës suaj, kërkojmë që të garantohej prezenca e përfaqësuesve të shoqërisë civile, pra transparenca në komision. Në këtë rast, ne si Koalicion i Vëzhguesve Vendorë do të bëjmë zyrtarisht kërkesën për të ndjekur mbledhjet e komisionit dhe të grupit të ekspertëve. Kjo është e protokolluar zyrtarisht.

Mendojmë se është me vlerë që ky komision të rrezatojë atë lloj transparence që kërkojmë të ndikojë në procesin zgjedhor. Gjithashtu kërkohet që ky komision të udhëhiqet nga parimi i transparencës së plotë, veçanërisht i një dinamike më të plotë lidhur me zbardhjen e diskutimeve, kontributeve të ardhura nga aktorët vendorë dhe ekspertiza e huaj, konkludimet e vetë komisionit mbi propozimet e ardhura. Të gjitha këto të jenë në kohë të plotë për të informuar publikun.

Për sa i përket përmbajtjes së çështjeve që pritet të shqyrtohen nga komisioni, ne do të sugjerim, që, përpos çështjeve prioritare, që u thanë këtu, të përfshihet ajo që ne e konsiderojmë primare në situatën aktuale, të bëhet adresimi në mënyrë integrale i mekanizmit të transparencës dhe të kontrollit të veprimtarisë financiare të partive politike e subjekteve zgjedhore, pavarësisht përmirësimeve të bëra në zgjedhjet e fundit, sërish ka nevojë për një adresim të plotë e të thelluar të kësaj çështjeje, sjell në vëmendje se edhe vullneti politik i shprehur nga krerët e partive politike kryesore parlamentare ka qenë, gjithashtu, i njëjtë për të adresuar këtë fenomen.

Unë mendoj se koha e mjaftueshme, të paktën deri në qershor, entuziazmi dhe konsensusi i treguar nga partitë politike në këtë komision do të ofrojnë një kuadër të mirë për trajtimin në aspektin financiar të partive politike dhe subjekteve zgjedhore që do të futen në zgjedhje.

Së dyti, të bëhet një adresim i rregullimit tërësor, ndërtimit dhe funksionimit të administratës zgjedhore në nivelin e dytë.

Nga vëzhgimi i bërë nga koalicioni në zgjedhjet e fundit dhe disa mënyrave të specifikuar të vëzhgimit, ne mendojmë se është me shumë vlerë që ajo që është folur si aspiratë, për të pasur një administratë zgjedhore të pavarur dhe jo politike, mund të fillojë pikërisht nga niveli i dytë, pra nga komisionet zonale të administrimit zgjedhor. Kjo është e rëndësishme për një sërë aspektesh, duke filluar nga pjesa procedurale, që duhet të memorizohet, nga problematika e hasur në këtë proces zgjedhor e të tjerë. Nuk dua të zgjatem, pasi ju jeni vënë në dijen nga raportet që ne i kemi paraqitur. Nga ana tjetër, kjo përbën edhe shkallën e parë të drejtësisë zgjedhore. Kështu, nga kjo pikëpamje, ne mendojmë se do të ishte më efikase, më efciente, mundësisht edhe më e realizueshme që të synohet pikërisht kjo hallkë e dytë. Pra, le ta quajmë mesin e artë të pavarësisë së administratës zgjedhore, pasi, sigurisht, në qëndrimin tonë, siç ne e kemi deklaruar, nuk besojmë se partitë politike janë të gatshme të heqin dorë, sikundër e kanë treguar, ndaj KQZ-së apo ndaj komisioneve të qendrave të votimit. Në raport me këtë ndoshta mund të flitet edhe për anëtarë të pavarur në procesin e grupeve të numërimit, procedura e të cilave, duke ndarë një shqetësim tjetër me ju, lë për të dëshiruar.

Për herë të parë koalicioni ka marrë të gjitha filmimet e numërimit të qendrave të votimit në vendet e numërimit të votave. Sigurisht që ne mendojmë se edhe partitë politike me njëjtën cilësi i marrim këto filmime, por, realisht, është për atë ardhur keq, nëse një subjekt politik do të dëshironte që ta trajtonte çështjen lidhur me pretendimin e rezultatit të zgjedhjeve duke u bazuar në këto filmime, pavarësisht vendimeve kundërshtuese, që ne kemi në praktikën zgjedhore, që këto filmime edhe janë marrë, edhe nuk janë marrë në konsideratë, qoftë nga KQZ-ja, si barrë prove, qoftë edhe nga Kolegji Zgjedhor.

Së treti, të bëhet adresimi i ndërtimit të një mekanizmi transparence specifik dhe efikas i të gjithë procesit zgjedhor. Sigurisht që ligji i ri i informimit publik është një mekanizëm shumë i mirë, që ndihmon aktorët e shoqërisë civile, por edhe qytetarët. Ne mendojmë që specifikisht për procesin zgjedhor të ketë përcaktime shtesë në kohë, që të detyrojnë çdo operator të përfshirë të japë informacion të plotë dhe në kohë reale. Për administratën zgjedhore ne sugjerojmë që, falë adoptimit të teknologjive të informacionit, të mund të kemi informacion online jo vetëm për KQZ-në, që, për fat të keq, vazhdon ende të mos jetë aq transparent, me gjithë përmirësimet e dukshme, sepse ka vendime që ende nuk janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, veçanërisht me komisionet zonale të administrimit zgjedhor.

Sa për informacion, për të ndarë shqetësimin me ju, ne i kemi kontaktuar nëpërmjet vëzhguesve afatgjatë, por edhe zyrtarisht 90 komisionet zonale të administrimit zgjedhor dhe

asnjë prej tyre nuk na ka kthyer përgjigje lidhur me vendimmarrjet, që janë detyrime ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në udhëzimin e KQZ-së. Jo vetëm kaq, por, falë disa kopjeve të dokumentacionit të vendimmarrjeve të komisioneve zonale të administrimit zgjedhor, ju siguroj se shumica e vendimmarrjeve, pavarësisht se këto komisione ngrihen 3 muaj para ditës së zgjedhjeve, duke qenë se janë ditët e fundit të parazgjedhjeve, do të thotë se ngrihen dyshime shumë të mëdha në atë se si këto komisione kanë funksionuar për aktorët e papërfaqësuar apo edhe për qytetarët.

Së katërti, sërish në planin e punës, ne sugjerojmë se thelbësore për ne është që të bëhet një adresim tërësor për një sistem funksional dhe efikas të drejtësisë zgjedhore. Pra, i mekanizmit të fundit, që mund të sjellë në mënyrë më objektive rezultatin nga kalkulimet që bëhen gjatë procesit zgjedhor. Gjithashtu, ne kemi propozuar edhe elemente të tjera, siç janë elementet e manipulimit apo ndërtimit të votës para zgjedhjeve, që të mund të konsiderohen të tilla, sepse nëpërmjet mekanizmit të drejtësisë zgjedhore mund të unifikojmë edhe procesin zgjedhor. Pra, jo vetëm ato të cilat mund të vërehen gjatë procesit të zgjedhjeve.

Këto ishin 4 problematikat kryesore, që ne sugjerojmë që të jenë në planin e punës së komisionit. Njëkohësisht 4 sugjerimet e mëparshme ishin për mënyrën e funksionimit të komisionit tuaj. Koalicioni do ta ndjekë nga afër dhe të shpresojmë në një përgjigje pozitive për statusin e vëzhguesit të koalicionit në komision dhe pranë grupit të ekspertëve. Sigurisht, çdo tematikë dhe çdo çështje do të paraqitet në matricën që ju përmendët pak më parë, gjithashtu do të ofrojmë edhe rekomandimet dhe qasjet tona në vazhdimësi.

Faleminderit!

Blendi Çuçi – Faleminderit, zoti Gogo dhe zonja Meta, për paraqitjen tuaj!

Para se të kalojmë te përfaqësuesi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, kush ka pyetje?

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Çuçi!

Lidhur me prezantimin e bërë nga përfaqësuesit e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, nga zonja dhe zotëria, absolutisht momenti sot është për të krijuar partneritete të suksesshme dhe të shëndetshme, data është e tillë. Por që shigjeta e Kupidit të shkojë atje ku duhet mirë është që partneriteti të jetë edhe serioz. Besoj se ky komision ka krijuar hapësirën më të gjerë të mundshme jo vetëm për ju, por edhe për medien, keni hapësirën tuaj që sensibilitetet tuaja të përcillen në mënyrë energjike në këtë komision dhe të trajtohen në mënyrë zyrtare. Pjesën e parë të rekomandimeve do ta rishikojmë, edhe pse nuk ishte vendi për t'i thënë ato.

Për pjesën e dytë unë kam interes personal, besoj se edhe kolegët, ju paraqitët 4 rekomandime, i sintetizuat në 4 çështje, apo jo? Janë thelbësore përpos të tjerave. Duke

qenë se jeni një koalicion që përmblihdni disa shoqata apo grupe që për një kohë të gjatë jeni marrë dhe keni një eksperiencë të pretenduar mbi eksperiencat elektorale të këtij vendi, do të doja dhe besoj se është një kërkesë racionale imja që përveç rekomandimeve që ju me të drejtë ia ofroni këtij komisioni, të dija nëse për këto 4 rekomandime thelbësore apo përpos të tjerave, a keni studime konkrete të bëra empirike apo teorike, pak rëndësi ka nga të cilat ju të keni ekstraktuar të gjitha këto 4 rekomandime thelbësore apo të tjera? Serioziteti i partneritetit që krijon edhe një rrugë të shëndetshme për në të ardhmen, besoj se duhet të nisë nga kjo. Nëse i keni, personalisht nga ana ime jeni të lutur të m'i vini në dispozicion.

Këtë kam si kërkesë.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Në fakt, nuk më interesojnë shumë studimet tuaja, keni apo nuk keni, kjo është çështje që i takon opozitës, jepjani studimet!

Unë kam një pyetje më të drejtpërdrejtë, e shikoj se ju jeni më afër opozitës, edhe letrën ia drejtoni të parit Oerdit dhe jo Bledi Çuçit, që i fillon emri me “B”, sipas alfabetit.

Pyetja ime është: 4 çështjet që trajtoni, a mund të na i përktheni në nene të caktuara të cilat ju ndihmojnë ju, që keni vëzhguar në terren, na ndihmojnë edhe ne si komision për të rregulluar Kodin Zgjedhor? Pyetja ime është më e thjeshtë.

Faleminderit!

Bledar Çuçi- Ka pyetje tjetër nga kolegët? Nuk ka.

Po, zoti Gogo.

Premto Gogo- Ju falënderoj për pyetjet!

E para, zoti Alibeaj nuk mendoj se koalicioni pavarësisht se është për konsum publik, qasja jonë këtu nuk ju duket serioze, përkundrazi. Koalicioni sidomos pas reformës së vitit 2012 ka qenë prezent dhe është i vetmi aktor që ka ndjekur nga afër çdo proces politik institucional ose jo që lidhet drejtpërdrejtë me çështjet zgjedhore, jo vetëm Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në mënyrë absolute çdo mbledhje dhe veprimtari të tij, jo vetëm në proceset zgjedhore, por edhe procese të tjera, duke përfshirë dekriminalizimin për të cilat ne kemi dalë herë pas here me qëndrime publike, me raporte, me deklarata, letra të hapura aq sa nuk dimë çfarë emrash të përdorim për natyrën e ndryshme të dokumenteve që ka prodhuar koalicioni.

Lidhur me çështjet në fjalë, për kontributin e koalicionit, e keni në arkivën e Kuvendit, të paktën për vitin që kaloi nuk është thjesht i fokusuar në monitorimet sipas një

metodologjie të caktuar, por është në vazhdimësi. Nëpërmjet ekspertizës së tij, personave, stafit të tij, bashkëpunëtorëve pa diskutim bën një konsultim të plotë edhe të legjislacioneve të tjera, edhe të diskutimeve më koherente që mund të jenë sot lidhur me çështje të ndryshme. Për çështjen e financave të partive politike në tetor të vitit 2016 ka publikuar një dokument që është opinion mbi financimin e partive politike dhe subjekteve zgjedhore, është depozituar edhe këtu, përfaqësues të parlamentit dhe të komisionit në atë kohë janë ftuar në tryezë dhe në vazhdimësi ka ofruar rekomandime konkrete. Pa diskutim shoqërohet jo vetëm me gjetjet nga monitorimi, por edhe me studime të mirëfillta të natyrës së çështjeve zgjedhore, por edhe sikur të ishte sërish vetëm thjesht në çështjet e monitorimit eksperiencia e gjerë për më shumë se një dekadë, këto gjetje që vazhdojnë të jenë të njëjtat marrin format e gjetjeve nga diskutimi, apo jo?

Në radhë të parë ne jemi këtu për të përfaqësuar shqetësimin qytetar. Nga kjo pikëpamje, në pjesën e ngritjes së shqetësimeve se ne përfaqësojmë grupime të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile, këto janë çështje realisht serioze, sepse shqetësojnë qytetarët.

Për pjesën tjetër të kontributit në vazhdimësi për të dalë edhe te përgjigjja e zotit Fino, pa diskutim që ne jemi të gatshëm të kontribuojmë, nëse ju vendosni dhe kërkonit që edhe ne të kontribuojmë për nene të posaçme apo amendimet e duhura jo vetëm në Kodin Zgjedhor, në ligjin “ Për partitë politike, por edhe në ligje të tjera.

Ne kemi qenë të gatshëm, e kemi treguar këtë, por do t’ju luteshim shumë që të merrni një vendim politik, të përcaktoni se çfarë realisht do të bëni ju, në mënyrë që edhe ne burimet tona të mos i ezaurojmë sikundër i kemi bërë.

Për pjesën e dokumentimit të diskutimeve që bëhen, absolutisht që është një gjë shumë e mirë për çështjet studimore, por që të mund të fokusohemi dhe të jemi më të qartë, më të plotë në elemente të cilat realisht kanë shumë rëndësi që të preken nga ju në kuadrin ligjor të zgjedhjeve.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Përfundimisht, ka apo nuk ka studime: do t’i sillni apo jo në tryezën e Komisionit për Reformën? Kaq e thjeshtë është.

Gerta Meta - Zoti Alibeaj, një ndërhyrje të shkurtër.

Unë ju falënderoj që jeni shumë kurioz në lidhje me historikun e koalicionit. Natyrisht, ne e pohojmë se kemi edhe studime të tilla, por do të doja të bëja një pyetje të drejtpërdrejtë: ne kemi harxhuar kohë dhe kemi sjellë rekomandime të afatshkurtra e

afatgjata, të cilat i kemi paraqitur para komisionit sa herë që keni kërkuar komente nga koalicioni i vëzhguesve vendorë. A mund të na thoni se sa prej tyre keni marrë në konsideratë dhe pse ka ndodhur kjo gjë? Kështu, nëse do të fillojmë të bëjmë polemika të tilla, të cilat nuk ju ndihmojnë as juve e as neve, mendoj se nuk është e seancave dëgjimore qasja për të treguar historikun, që kemi apo s'kemi studime.

Ideja është që qytetarët shqiptarë, që ndoshta po na ndjekin përmes televizioneve, gazetarët e të cilëve keni thërritur sot, duhet ta dinë se ka një vullnet politik final, që përfundimisht, Komisioni i Reformës Zgjedhore do të bëjë amendimet e duhura e do të ketë një kod zgjedhor, do të ketë më në fund një historik me vlerë në lidhje me proceset zgjedhore, që do të jenë procese me integritet.

Kësisoj, në qoftë se do ta mirëkuptojmë dhe do ta mbështesim njëri-tjetrin, për të realizuar këtë lloj finaleje, le të fillojmë me pozitivitet, ashtu sikundër dëgjuam se këtu ka gjasa për të bërë gjëra të mira të gjithë së bashku.

Ju falënderoj!

Bledar Çuçi – Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Çuçi!

E para, nuk ju kërkoja gjë në lidhje me historikun e koalicionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, aspak! Dëgjoni tani!

Meqë kërkuat dialog, ja ku u vendos dialogu. Dialogu mund të mos jetë lavde reciproke. Ju kujtoj këtu se kohë më parë edhe unë kam qenë në tavolinën ku edhe ju keni qenë. Duke marrë sensibilitetet e asaj tavoline ku unë kam qenë dikur, në mënyrë që këto të mos jenë një *déjà vu* e eksperiencave të kaluara, në mënyrë që zëri i shoqërisë civile, posaçërisht juaji si koalicion, të mos mbetet thjesht e vetëm si listë dëshirash, sigurisht kjo kërkon seriozitet nga kjo anë e dialogut, po para së gjithash nga ana e andejme e dialogut.

Unë besoj se nuk ka rrugë më të mirë, që kjo anë e dialogut të dëgjojë, shpresojmë kësaj radhe një herë e mirë, do të duhej që, nga ana juaj, ato rekomandime të mbivendosura, shpeshherë edhe të lënë nën pluhurin e harresës, të kenë edhe një virtyt: faktin që të mos jenë thjesht e vetëm produkt i kërkesave për fonde e projekte, se sa produkt i një veprimtarie serioze studimore të asaj çfarë ndodh në terren. Kjo bën që serioziteti të ngrihet në piedestal. Prandaj kërkoja studime. E kam edhe kohën, edhe ngenë për t'u marrë me këtë punë.

Këtu e mbyll. Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Bashkim Fino – Në qoftë se i kemi thirrur këta, në fakt këtë e keni bërë ju, si bashkëkryetar, i kemi thirrur t'i dëgjojmë, të na japin materialin, e pastaj të bëjmë edhe ndonjë pyetje. Në qoftë se i kemi thirrur për t'u thënë: sa fonde merrni ju për të bërë një studim, kjo nuk është në interesin e këtij komisioni. Nëse është në interes të atij grupit andej, le t'ua bëjnë këto pyetje më pas, kur të mbarojë mbledhja. Mua nuk më intereson kjo. Mua më intereson trajtimi i problematikave, që t'i kthejmë në normë, t'i kthejmë në Kodin Zgjedhor.

Prandaj, ju bashkëkryetarët duhet të jeni një çikë më të vëmendshëm, që ta bëjmë të saktë këtë dëgjese, e të mos e bëjmë me replika të pakëndshme.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Fino!

Unë besoj se kërkesa e zotit Alibeaj, pore dhe kërkesa që bëtë ju më herët, ka lidhje me faktin se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kishit një pyetje? Në rregull!

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Në vazhden e diskutimeve të kolegëve, kam një pyetje, që më saktë është edhe sugjerim, e cila lidhet me rekomandimet që vijnë nga koalicioni i vëzhguesve vendorë, në bazë të eksperiencës që kanë pasur në çdo proces zgjedhor, si dhe rekomandimet që kanë ardhur, për t'i parë ato më të integruara në një dokument ku, pas çdo procesi zgjedhor: cilat janë problematikat, cilat janë mënyrat për t'i adresuar, gjëra të cilat duhet t'i reflektojmë në ndryshimet e neneve përkatëse të Kodit Zgjedhor.

Në lidhje me çështjen nëse ka studime, mua më duhet që në fund të kemi propozimet tuaja, edhe me ndryshimet përkatëse. Besoj se kjo do të ishte mënyra e duhur për ne, që të jemi në shërbim të njëri tjetrit, dhe në fund të arrijmë te ajo që presim të gjithë: ndryshimet përkatëse. Nga ana jonë vullneti ynë politik, nga ana juaj eksperiencia dhe problematikat që keni hasur në terren, dhe se si mund t'i adresojmë këto në ndryshime.

Besoj se nga ana jonë këtu, nevojitet një mënyrë tjetër e të komunikuarit me ata që i ftojme për t'i dëgjuar, ndërsa nga ana juaj, besoj, e këtu e kam me përfaqësuesit e koalicionit të vëzhguesve vendorë, më shumë se sa të sugjeroni si duhet të jemi ne, unë mendoj se duhet të na sugjeroni me veprime konkrete: çfarë duhet të ndryshojmë ne, në mënyrë që të jetë e lexuar siç duhet vota e atyre që votojnë dhe zgjedhin në fund.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Po, zoti Rama.

Luan Rama – Faleminderit!

Jemi në një seancë dëgjimi, në fillim të procesit të punës së këtij komisioni, për ta vendosur gjithë procesin e reformës zgjedhore në ato standarde e parametra që rekomandon edhe partneriteti ynë me organizmat ndërkombëtare, kryesisht me OSBE/ODIHR-in, që më në fund, Shqipëria të mund të mbërrijë të mos kemi probleme me zgjedhjet e me atë që vjen pas zgjedhjeve.

Unë mendoj se këtu nuk jemi as në vendin e as në kohën e duhur për t'i treguar kufijtë njëri-tjetrit. Jemi në një proces bashkëpunimi, që duhet të jetë shumë serioz, shumë korrekt, shumë institucional. Edhe nëse kërkojmë të dimë diçka më shumë mbi mënyrën e studimit apo të sondazheve që ju bëni, për t'i sjellë pastaj te rekomandimet, kjo nuk ka pse të merret si fyerje, po përkundrazi është shenjë vlerësimi dhe respekti për punën që ju bëni. Ashtu sikundër këtu nuk ka emra individualë në këtë tavolinë nga pala këtej e dialogut. Për emrat individualë mund të kemi konsiderata të ndryshme. Këtu është një institucion, që është institucioni i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Dhe për sa kohë është i tillë të gjithë ata që komunikojnë me këtë institucion duhet të jenë shumë korrektë, shumë seriozë dhe të ruajnë etikën e komunikimit në një institucion përfaqësimi të lartë...

(Zoti Fino flet pa mikrofon.)

Luan Rama – Bashkim, unë nuk të ndërpreva. Unë nuk pranoj nga askush leksione se çfarë duhet të them unë. Nuk mund të më thuash ti se çfarë duhet të them unë. As sugjerime.

Bashkim, unë as nuk ndërpres, as nuk fyej askënd, as nuk bëj didaktikë me askënd, as nuk mësoj askënd. Dëgjoj me shumë vëmendje, siç të dëgjova edhe ty kur fole. Jam dakord me pjesën racionale të asaj që the, por më lejo të them unë atë që di unë të them. Dhe më lejo të të them se atë që unë e di e them më mirë se ty dhe se kushdo tjetër.

Pra, ne jemi këtu të mirëpresim dhe të punojmë së bashku me ju për t'i ikur këtij teatri të shëmtuar që bëjmë ne dhe me të politikës, pikë së pari. Kemi 20 vjet që bëjmë reforma zgjedhore dhe pas 20 vjetësh prapë jemi te pika e fillimit, me një standard skandaloz zgjedhjesh dhe me produkt kriminal zgjedhjesh. Këtë kemi për mision të bëjmë dhe këtë duhet ta bëjmë të gjithë së bashku. Kush nuk është i zoti të ecë në këtë trend dhe në këtë rrugë, le të hapë krahun, sepse ka të tjerë që e bëjnë më mirë.

Unë jam krejtësisht i hapur, zoti kryetar, që partneriteti dhe vjedhjen e çdo kontributi pozitiv që vjen nga shoqëria civile, në mënyrë të veçantë nga koalicioni i vëzhguesve zgjedhorë, ta konsiderojmë maksimalisht me të gjithë ndjeshmërinë tonë pozitive për të realizuar këtë reformë.

Faleminderit!

Bledar Çuçi - Faleminderit!

Besoj se e shkarkuam edhe pjesën që e kishit me merak, pjesën me debat, sepse nuk shkoni dot pa debat.

Mendoj që pjesa racionale nga i gjithë ky debat lidhet me faktin që ky komision ka nevojë të furnizohet vazhdimisht qoftë edhe me ide se si mund të ndryshohet, edhe me burime se nga vijnë këto ide, qoftë edhe me propozime konkrete, për ndërhyrje konkrete në legjislacion. Pra, të dyja janë të vlefshme, ne prandaj bëjmë seanca dëgjimore. Nuk diskutohet fakti që patëm një seancë dëgjimore sot me koalicionin e vëzhguesve vendorë. Në rastin konkret kjo nuk do të thotë që ne nuk do të komunikojmë më si komision me këtë institucion. Gjithmonë ky komision është i hapur, sidomos për çështje që ju i keni ngritur, apo që keni bërë rekomandime si kryesore. Mendoj se jeni më shumë se të mirëpritur. Në momentin që ky komision do të përpunojë politika se si do ta zgjidhim në legjislacion çështjen e caktuar, që lidhet me rekomandimet tuaja, jeni të mirëpritur të bëni dhe propozime konkrete në ndërhyrje konkrete legjislacioni.

Për sa i përket pjesës historike, po ju them një gjë. Historinë e lexon komisioni, jo të ftuarit. Dhe aq herë sa do të thirrëni, jo nga ky komision, por nga kushdo komision parlamentar, ose jo, në lidhje me këto çështje, unë gjykoj se duhet të jeni të përgatitur sikur asgjë nuk është thënë më përpara dhe nuk është bërë më përpara. Sepse presupozohet se puna që zhvillon komisioni, e gjykon komisioni se cila është gjëja që duhet ose nuk duhet të marrë, dhe e gjykon komisioni që nëse janë relevante ose jo çështjet për të cilat ju do të kontribuoni.

Kjo ndërhyrje ishte thjesht për të vendosur një marrëdhënie korrekte midis nesh si parlamentarë ose si komision parlamentar, por edhe ju si përfaqësues të shoqërisë civile që thirrëni në komision për të dhënë kontributin tuaj të çmuar gjithmonë në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

Oerd Bylykbashi – Ajo që ngriti kolegu Alibeaj besoj se është shumë e rëndësishme, nuk ka lidhje me historikun e organizatës tuaj ose organizatave të tjera, por ka të bëjë me faktin se nga vijnë shqetësimet, si janë të dokumentuara. Sa më shumë ne ta kemi këtë informacion, aq më e qartë është për ne problematika, dhe jemi gjendje të kuptojmë magnitudën e këtij problemi për të vendosur si do të ndërhyjmë në këtë ligj.

Sigurisht, mund të ketë edhe rekomandime të pa faktuara, por ajo që ju thoni se ka pasur shitblerje vote, është në dritën e diellit, edhe të mos shkruanit asgjë në tekst për këtë, të gjithë e dimë që ka. Nuk ishte te çështjet që ngritët, por, besoj, e keni te raportet e tjera.

Unë i vlerësoj kërkesat tuaja, do të shohim me kujdes ato paraqitët sot këtu. Sigurisht është ky komision që do t'i çmojë në të mirën e punës dhe të efikasitetit, duke garantuar

transparencë, por, mbi të gjitha, efikasitetin. Produktin në nivelin më të mirë të mundshëm duhet ta japim brenda afatsh të përcaktuara nga seanca plenare.

Për rrjedhojë do ta vlerësoja shumë bashkëpunimin. Kjo do të thotë se komisioni ka për detyrë të trajtojë rekomandimet e OSBE-ODHIR-it dhe çështje të tjera që ngrihen nga partitë parlamentare në këtë komision. Duke qenë se ne uahapim derën plotësisht propozimeve tuaja, do të ishte me shumë vlerë që ju të bëni një përmbledhje të të gjithave, si ta gjykoni ju në më të mirën e mundshme të problematikave dhe rekomandimeve tuaja, sepse grupi i ekspertëve ka një volum pune të jashtëzakonshëm dhe nuk mund t'i kërkojmë të shqyrtojë, po themi, raportimet në historik të organizatave të ndryshme. Kjo do të na ndihmonte, do të ishte shumë e vlefshme qoftë për komisionin, qoftë për grupin ekspertëve.

Faleminderit, koalicionit për prezantimin dhe çështjet që ngriti, vazhdojmë më tej me Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

Duke qenë deputetët do të bëjnë pyetje, ju lutem, të jeni sa më efikasë te minutat që keni në dispozicion!

Andi Muratej – Ju falënderoj për ftesën për të paraqitur disa nga mendimet tona lidhur me proceset zgjedhore!

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një organizatë që ka monitoruar procesin zgjedhor që nga viti 1996 dhe në vazhdim, në publikimin e listave paraprake, në fushatën zgjedhore, në ditën dhe procesin e numërimit të votave. Pas çdo verifikimi të zgjedhjeve ne kemi hartuar raportin me rekomandime konkrete. Edhe në zgjedhjet e fundit ne kemi hartuar një raport me rekomandime konkrete, të cilat do t'ia vëmë në dispozicion komisionit që të mbahen parasysht gjatë hartimit të planit të punës në vazhdim.

Sot do të mundohem në mënyrë konkrete të parashtoj disa nga çështjet kryesore që përfshihen në raportet dhe rekomandimet tona.

Së pari, çështje parësore është depolitizimi i organeve të administrimit zgjedhor. Gjykojmë se duhet të jetë prioritar edhe në punën e këtij komisioni. Po ashtu mendojmë se do të ishte më e përshtatshme që depolitizimi i këtij organi të fillojë nga organet më të larta, pra nga KQZ-ja.

Kjo do të rriste besimin, paanshmërinë e subjekteve zgjedhore në radhë të parë, por edhe të publikut te organet e administrimit zgjedhor.

Një çështje tjetër është edhe ligji për dekriminalizimin, i cili është një ligj shumë i rëndësishëm, por afatet që parashikohen në Kodin Zgjedhor për verifikimin e formularëve të kandidatëve që përfshihen në listat zgjedhore janë shumë të shkurtër dhe KQZ-ja e ka të pamundur të verifikojë pastërtinë e figurës sipas kriterëve që ka ky ligj.

Për rrjedhojë gjykojmë që këto afate duhet të kenë kohën e vet. Gjithashtu në Kodin Zgjedhor mendojmë se duhen të Gjithashtu në Kodin Zgjedhor mendojmë se duhet të përkufizohen më mirë kompetencat që ka KQZ-ja në raport me organin e prokurorisë, pasi në zgjedhjet e fundit ka pasur disa probleme mosmarrëveshje paqartësi për probleme të diskutueshme midis këtyre organeve, pra KQZ-së dhe organit të Prokurorisë dhe kjo është një çështje me rëndësi.

Gjithashtu, në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR-i gjykojmë që do të ketë një kontroll më të thelluar të financimit të fushatave zgjedhore, para gjatë dhe pas mbarimit të saj. Auditet e pajtuara nga KQZ-ja kemi vënë re se nuk kanë evidentuar asnjë mospërputhje në raportin e tyre sa i takon financimit të fushatave zgjedhore dhe kjo çështje meriton rëndësi të veçantë.

Gjithashtu, jemi dakord me çështjen e votimit të emigrantëve. Kjo është një çështje me shumë rëndësi, është realizimi i të drejtave të ligjshme, që kanë shtetasit shqiptar që jetojnë jashtë Shqipërisë për të votuar. Por kjo kërkon një proces real dhe të saktë verifikimi të tyre, po ashtu do të mbahen parasysh edhe praktikatat e vendeve të tjera të Bashkimit Europian, si e kanë rregulluar çështjen e votimit të emigrantëve, duke pasur parasysh ruajtjen e raporteve midis votës së shtetasve shqiptarë jashtë Shqipërisë dhe votës së shtetasve shqiptarë që jetojnë në Shqipëri. Gjermania ka një praktikë, sipas së cilës, votojnë shtetasit gjermanë që jetojnë në Këshillin e Europës, dhe jo në shtete të tjera për shkak të largësisë, sigurisht duke ruajtur parimin e barazisë së shtetasve në raport me votën.

Gjithashtu, një çështje tjetër është ajo e barazisë së vëzhguesve të jashtëm dhe vëzhguesit e partive politike gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave. Kodi Zgjedhor në nenet 6 dhe 7 nuk u jep të drejta të barabarta vëzhguesve të jashtëm me vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, pasi në procesin e numërimit vëzhguesit e jashtëm nuk kanë të drejtë të bëjnë vërejtje edhe kjo është po ashtu duhet mbajtur parasysh me qëllim që vëzhguesit e jashtëm që nuk janë përfaqësues të partive politike të kenë mundësi të paraqesin vërejtje gjatë procesit të numërimit të votave. Këto janë disa nga çështjet më të rëndësishme.

Në fakt, në raportin tonë ne kemi edhe çështje të tjera dhe më konkretisht do t'i parashtrojmë duke iu referuar dispozitave konkrete të Kodit Zgjedhor dhe në vazhdim shpresojmë të jemi pjesë e këtij procesi gjithëpërfshirës, transparent. Sigurisht që do të kishim dashur të ishim pjesë e konsultimeve, materialeve dhe e produkteve të këtij komisioni me qëllimin që brenda afateve kohore të arsyeshme të japim edhe ne mendimet tona.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – A ka nga kolegët ndonjë gjë?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Ferhati (Bushka) – Faleminderit, zoti Muratej!

Në fakt, pjesëmarrja juaj në këtë dëgjese të komisionit është shumë e rëndësishme, jo vetëm sepse tashmë përfaqësimi i qytetarëve nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile në këto mbledhje dhe takime pune të komisioneve të Kuvendit është i rëndësishëm për të përcjellë zërin e qytetarëve dhe shqetësimet e tyre, të cilat në rastin konkret do të na duhet t'i marrim në konsideratë në harmoni me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, në mënyrë që në fund produkti ynë të jetë një produkt dinamik gjithëpërfshirës, por edhe për faktin se duke ushtruar të drejtën e monitorimit të njohur nga Kodi Zgjedhor, organizatat e shoqërisë civile vijnë këtu me fakte, me gjetje konkrete të procesit dhe me problematika, të cilat në vite mund t'i shohim se si ndryshojnë, shtohen, përmirësohen apo ngelin në të njëjtin *status quo*.

Personalisht, i kam lexuar raportet e koalicionit të vëzhguesve vendorë, si dhe raportet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe, në fakt, shoh që edhe në prezantimin e zotit Premto, por edhe në prezantimin tuaj bëni një propozim që vetë personalisht e përqafoj, por do të na duhet ta elaborojmë në komision për të gjetur zgjedhjet efektive. Konkretisht, jam duke folur për depolitizimin e organeve zgjedhore të nivelit të dytë në mënyrë që të rritet transparencja, besimi i publikut te procesi zgjedhor, si dhe t'i jepet një qëndrueshmëri në besueshmëri këtij sistemi. Pyetjet që unë kam, ndoshta jo vetëm për ju, por edhe për përfaqësuesit e tjerë të shoqërisë civile kanë të bëjnë me faktin, si koncept, si ide është e pranueshme në mendimin tim, por edhe nga eksperiencia që ju mund të keni, por edhe nga studimet që ju mund të keni bërë dhe nëse i keni, jam dakord me zotin Alibeaj, është mirë që t'i sillni, sepse gjithçka do ta pasuronte punën e këtij komisioni, kush mund t'i propozojë? Kush do të jetë organi që i rekruton, që i trajnon?

Pra, do të doja diçka më konkrete, sepse që mund të jenë të depolitizuar anëtarët e organeve të nivelit të dytë mund të biem dakord, por kush është një mënyrë e mirë që ta garantojmë se ata janë të depolitizuar. Nga eksperiencia që keni, cila mund të jetë një ide?

Andi Muratej - Në fakt, ky nuk është një proces i thjeshtë për të identifikuar se cilat janë zgjidhjet më të mira për të pasur një administratë zgjedhore të depolitizuar.

Mund të ketë praktika shumë të mira, por gjithsesi duhet parë se si e kanë zgjidhur këtë çështje edhe vendet e tjera europiane. Gjykoj se duke përfshirë më shumë qytetarët e thjeshtë, së pari, duhet që këto struktura zgjedhore të mos përbehen nga përfaqësues të partive politike. Duhet të ketë vullnet për këtë çështje për sa u përket partive politike dhe subjekteve zgjedhore, që këta persona të mos jenë përfaqësues të mirëfilltë të mbrojtjes së interesave të subjekteve zgjedhore. Kush mund të përfshihet në këto organe? Mund të jenë qytetarë të

thjeshtë, arsimtarë, avokatë, pensionistë në gjendje të mirë fizike, pra, duhet parë se cilët mund të jenë ata persona që nuk e bëjnë këtë proces politik.

Ne mendojmë që depolitizimi, në radhë të parë, duhet të fillojë nga nivelet e larta dhe, në qoftë se ka presion politik nga organet e ulëta të administrimit zgjedhor, organet e larta, duhet ta menaxhojnë me shumë objektivitet, pavarësi dhe të krijojnë më shumë besueshmëri për të bërë një proces sa më real, për sa i takon leximit të votës.

Oerd Bylykbashi - Fjala për zotën Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Për të parë kushtet, duhet ta bëj edhe te ju pyetjen që bëra më parë, e kam fjalën për studime. Studime, nuk do të thotë gjë tjetër përveçse faktit, që organizata juaj, si edhe ajo paraardhëse, presumohet që përgjatë episodeve elektorale keni bërë ekspedita eksploratore në terren për të parë fenomenet që difektojnë procesin elektoral. Ne kemi si pretendim, që një nga defektet e procesit është shitblerja e votës, madje, edhe ata të OSBE-ODHIR-it e kanë thënë këtë gjë në rekomandimin e tyre.

Po lexoj raportin tuaj të datës 25 qershor dhe më rezulton se fjala “shitblerje e votës”, përmendet vetëm në tri fjali: e para, në media “U bënë publike disa prej pretendimeve të subjekteve zgjedhore për disa raste të shitblerjes së votës”.

Fjalja tjetër ku përmendet e njëjta fjalë: “Shitblerja e votës është e dënuar penalisht për Komitetin Shqiptar të Helsinikut, i cili vlerëson se kjo është kërkesë për ndërgjegjësimin e qytetarëve për të denoncuar dhe parandaluar këtë fenomen”.

Dhe e treta: “Në krahasim me zgjedhjet e kaluara, është pozitiv fakti që ka pasur një rritje të numrit të rasteve të denoncuara të krimeve elektorale, çka mundëson hetim të plotë, efektiv nga organi i prokurorisë”.

A e keni me të parë apo me të dëgjuar këtë historinë e shitblerjes? Dua të dal te kërkesa që bëra: ka nga ana juaj një studim ku ju të keni konstatuar *in prima persona* faktin e shitblerjes, apo ngelet thjesht dhe vetëm pretendim i disa subjekteve zgjedhore? Nëse ka një studim të tillë, jeni të lutur, edhe mbas 14 shkurtit, të na e sillni. Kjo është kërkesa që unë kam. Faleminderit!

Bledar Çuçi - A mbaruat? Mos ka edhe ndonjë nga kolegët, që të përgjigjemi njëherë e mirë? Fjala për ju zoti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Andi Muratej - Zoti Alibeaj citoi edhe vetë konstatimet tona në raport me shitblerjen e votës. Në radhë të parë, kjo është një çështje e përgjegjësisë penale dhe bën pjesë në Kodin Penal. Ne nuk kemi studime apo raste të veçanta të shitblerjes së votës. Kjo është një çështje penale që ligji penal, por edhe partitë politike, kanë përgjegjësi në këtë drejtim, pra, duhet të

distancohen ato, në radhë të parë, nga shitblerja e votës. Përveçse organi i prokurorisë duhet të bëjë punën e tij për të çuar para ligjit të gjitha rastet e shkeljes që parashikon edhe kreu i posaçëm i Kodit Penal për çështjen e votës. Nuk kemi studime të veçanta vetëm për këtë çështje, ne monitorojmë procesin zgjedhor në përgjithësi.

Bledar Çuçi – Faleminderit! Kalojmë tek i ftuari i fundit për sot, për dëgjuesë, por jo për nga rëndësia, sigurisht, zoti Kristaq Kume, nga Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor.

Kristaq Kume – Ju faleminderit!

Prezantimin e bëtë ju se cili jam. Gjëja e parë që dua të theksoj ka të bëjë me atë çka ju miratuat si platformë pune të komisionit që, për mua, të paktën, nisur nga deklaratat e bëra më parë, është një gjë që e vlerësoj jashtëzakonisht. Ka të bëjë me faktin se ky komision nuk do ta limitojë punën e tij vetëm dhe, kryesisht, në reflektimin në Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet e OSBE-ODHIR. Është i hapur për të trajtuar edhe çështje të tjera, siç është edhe çështja e shumëdebatuar, ajo e sistemit. Ajo bën në të njëjtën kohë atë që hapësira e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të mendimit, përvojave dhe ideve me njëri-tjetrin të jetë shumë më e madhe sesa pritej nga çfarë ishte deklaruar deri më sot.

Instituti që unë drejtoj, së bashku me kolegët e mi dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, me një kuptim të quajtur dhoma e situatës zgjedhore në kuadër të reformës zgjedhore, që nuk arriti të realizohej, të parafundit, në qoftë se quajmë këtë të fundit, ka depozituar një dosje të plotë me propozime për ndryshimet që mund të bëheshin atëherë, pra para zgjedhjeve të kaluara në Kodin Zgjedhor, të shoqëruara edhe me një material shumë të bollshëm, me një relacion shpjegues me të gjitha shpjegimet.

Pasi kam konsultuar edhe gjetjet për zgjedhjet e fundit, që ne dëshirojmë t'i sjellim në vëmendjen tuaj si punë që mund të bëhet, duke marrë edhe përvojën, edhe idetë tona, është e përputhshme në linjat e saj kryesore, me platformën që ju sapo miratuat.

Së pari, problemi për të cilin ne dëshirojmë të japim një ekspertizë, është ai që ka të bëjë me mundësitë ligjore që duhet të krijohen për të lehtësuar ngarkesën e madhe politike që ka administrata zgjedhore. Propozimet, dhe kjo nuk është vetëm ajo që unë dua të shtroj këtu, por rezultatet e shumë diskutimeve kanë qenë nga më të ndryshmet, duke filluar që nga ideja, sipas së cilës e gjithë administrata nuk duhet të jetë e ndërtuar mbi bazën e parimit të përfaqësimit politik, ashtu sikurse edhe realizimi hap pas hapi.

Për të realizuar këtë të dytën, që unë e shoh se është më e mundshme dhe mund të gjejë më shpejt dakordësinë politike midis palëve për t'u realizuar, në përgjigje të pyetjes që ju bëtë sesi mund të zgjidhet kjo punë, mendoj se duke e filluar procesin hap pas hapi që do

të thotë, të paktën në nivelin e dytë të komisioneve zgjedhore, njëri anëtar (anëtari i shtatë) të mos jetë me propozim të partive politike, sekretari i KZAZ-së të mos emërohet me propozim të ardhur nga partitë politike.

Më poshtë, komisionet e qendrave të votimit të përbëhen me nga 5 anëtarë dhe të mos vinë me propozim të partive politike. Grupet e numërimit të jenë po ashtu, totalisht nga qytetarët, gjë që mund të zgjidhet në radhë të parë, në rast se bihet dakord për të punuar për të, nëse do të angazhohemi për të zgjidhur problemin e parë: ku do t'i gjejmë këta njerëz që do ta bëjnë këtë punë. Kjo do të thotë se duhet të investohemi për të filluar një proces të gjatë, të vazhdueshëm dhe të përhershëm oferte trajnimit për qytetarët shqiptarë, të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e administratës zgjedhore në një proces zgjedhor dhe nën përgjegjësinë dhe detyrimin e KQZ-së të realizohet trajnimi i përhershëm i tyre, që këta njerëz të jenë të certifikuar, kualifikimi i tyre të jetë detyrë e KQZ-së, në kuadër të asaj që do të jetë shkolla për përgatitjen e administratorëve të zgjedhjes. Pastaj, duke krijuar një *database* të tillë me qytetarët që i kanë kaluar proceset e trajnimit, përzgjedhja e tyre për t'i angazhuar në administrimin në një nivel të caktuar, të një detyre të caktuar në administratën zgjedhore, për mendimin tim është problem që zgjidhet drejt edhe si procedurë.

Problemi i dytë, që do të doja të trajtoja këtu, ka të bëjë me sistemin apo më mirë të themi, me mënyrën si do të konvertohen votat në Kuvendin e Shqipërisë. Këtu ka opsione të ndryshme. Fakti që ky është problem shumë i ndjeshëm politik, më bën që të rezervohem, të mos t'i lexoj, as t'i paraqes se cilat mund të jenë opsionet dhe zgjidhjet, për sa kohë që nuk është realizuar, nuk është arritur dakordësia politike për ta trajtuar këtë gjë. Në momentin kur arrihet dakordësia politike, atëherë instituti që unë dhe kolegët e mi përfaqësojmë, është i gatshëm të japë setin e rekomandimeve apo mënyrave të zgjidhjes për problemin që natyrisht, ka të bëjë me sistemin, por më shumë sesa me sistemin, ka të bëjë me mënyrën e konvertimit të votave që mund të realizohet ndryshe, edhe pa prekur sistemin.

E treta, lidhet me problemin që edhe ju e keni të miratuar tashmë në platformën tuaj, që ka të bëjë me krijimin e mundësive për votimin e shtetasve që banojnë jashtë territorit të vendit, për të cilin unë do të thosha se të paktën deri sot është krijuar perceptimi që ka një dakordësi politike për ta trajtuar dhe për ta zgjidhur këtë problem, është bërë edhe një tryezë pune, një *workshop* në Kuvendin e Shqipërisë. Ajo që doja të thosha për këtë çështje është vetëm: bini dakord, pastaj zgjidhjet gjenden. Midis asaj se si mund të gjenden zgjidhjet është edhe materiali që instituti që unë përfaqësoj ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë me rastin e *workshop*-it të realizuar me këtë objekt.

E katërta, është trajtimi i mundësisë së përdorimit të teknologjisë së informacionit në zgjedhje. Parimisht keni rënë dakord që ta trajtoni këtë gjë për ta zgjidhur.

Unë do të thosha se e para gjë për të cilën duhet rënë dakord, është të trajtohet kjo vetëm duke u përpjekur të gjendet mundësia se si mund të përdoret teknologjia e informacionit në lehtësimin edhe në miradministrimin e votës dhe jo duke u larguar nga ajo që sa dhe si, në çfarë mënyre mund të përdorim ofertën e internetit, pra votimin e shtetasve, pa qenë të detyruar që të shkojnë në qendrat e votimit.

Rekomandimi që mendojmë se duhet të trajtohet dhe të bëhet pjesë e diskutimit është: përdorimi i teknologjisë gjithmonë duke mos hequr dorë nga ky fakt: shtetasi duhet të vejë në qendrën e votimit. Mendojmë se kjo gjë mund të bëhet dhe duhet të bëhet në qoftë se duke e testuar në fillim dhe testimi mund të bëhet nëpërmjet atyre që quhen projekte pilote, mundësi të mëdha janë zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore dhe pas kësaj mësimi, që do të dalë nga ajo çka mund të prodhojë pilotimi i kësaj gjëje: të shërbejë për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë.

Për mendimin tim, ka dy opsione se si mund të përdoren mundësitë që ofron teknologjia e informacionit.

Opsioni i parë është identifikimi biometrik i votuesit në qendrat e votimit, si dhe vlerësimi dhe numërimi, nxjerrja e rezultateve nëpërmjet skanimit të votës.

Opsioni i dytë është identifikimi biometrik i zgjedhësve në qendrat e votimit dhe votimi nëpërmjet një flete votimi dixhitale, pra nëpërmjet *touchscreen*-it. E rëndësishme është që gjithçka të konceptohet si një cikël i mbyllur brenda qendrës së votimit.

Çështje tjetër që vlen të diskutohet është ajo që ka të bëjë me mundësi më të mëdha, duke ruajtur këtë sistem zgjedhor që kemi, që duhet t'i jepen zgjedhësit për të zgjedhur alternativa të ndryshme. Një ndër to është votimi, mundësia për të votuar me lista të hapura.

Lidhur me financimin e fondeve në fushatat zgjedhore, një problem i madh i cili në të njëjtën kohë është edhe problemi që ka konsumuar më shumë energji, më shumë konsulta, që ka edhe më shumë ide se të gjitha problemet e tjera, në kuadrin e rregullimeve që do të bëhen në ligjin zgjedhor, ne mendojmë se, midis të tjerave, dhe këto janë thënë shpeshherë, do t'ia vlen të bëjmë në kuadrin ligjor, i cili është mirë edhe kështu siç është, të shtohen gjëra që kanë të bëjnë me pamundësinë e përfitimit që i vjen dikujt që paguan, që hedh para për një subjekt zgjedhor, çka do të thotë që me ligj të ndalohet.

Benefiti që mund të vijë, pas procesit zgjedhor, për ata të cilët do të paguajnë subjektin zgjedhor përkatës, është të konsiderohen shkeljet që kanë të bëjnë me dhurimin e

fondeve jopublike, si vepra penale, dhe këto të përfshihen në atë që quhet korrupsion zgjedhor, pra të mund të trajtohen dhe të gjykohen nga SPAK-u.

Për mendimin tonë nuk është koha t'i lihet Komisionit të Zgjedhjeve hapësira për të vepruar dhe për të marrë vetë ai vendim, duke përdorur kapacitetet aktuale që ai ka, por ligji t'i krijojë mundësitë që ky institucion përgjegjës t'i zhvillojë më tej kapacitetet, ashtu siç është përcaktuar në ligjin zgjedhor: për të monitoruar në kohë reale procesin e financimit dhe të monitorimit të fondeve në fushata zgjedhore. Pra, mund të trajtohet ideja e ngritjes së një bordi monitorimi për financimin e partive politike, bord i cili, si i tillë, të funksionojë jo vetëm gjatë dhe për fushatën zgjedhore, por edhe në përgjithësi për problemet e financimit të partive politike.

Po ashtu, për t'i krijuar mundësi më të mëdha pjesës jopolitike të shtetasve, pra organizatave të qeverisjes vendore, për të monitoruar edhe ato financimin e fondeve dhe përdorimin e tyre në zgjedhje, rekomandojmë që në Kodin Zgjedhor vëzhguesve vendorë t'u jepet e drejta me ligj për të pasur mundësinë të kenë akses të plotë tek informacioni që tregon se çfarë fondesh merr dhe si i përdor partia dhe të mos lihet vetëm me atë se vëzhguesi vendor ka të drejtë të marrë informacion për çfarë të dojë. Por duke qenë se deri sot praktika tregon se jo vetëm vëzhguesit, po edhe monitoruesit që angazhon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, partitë politike i bëjnë bisht dhe nuk ua japin informacionin në kohë reale, vëzhguesve vendorë t'u njihet kjo si një e drejtë e shprehur në Kodin Zgjedhor. Pra, jemi për atë që duhet, ndërkohë të trajtohet në Kodin Zgjedhor, duke iu referuar asaj se çfarë kërkohet në ligjin që thërritet, si rregull për dekriminalizimin, sepse nuk mjafton vetëm të thuhet aq sa shprehet në këtë ligj që unë sapo thashë, se dispozitat e tij prevalojnë mbi dispozitat e Kodit Zgjedhor në një kohë kur ka çështje që praktika vetë dhe përdorimi, zbatimi i këtij kuadri ligjor ka treguar se ia vlen të trajtohen. Unë kam të rreshtuara këtu disa nga problemet që duhet të atakohen, duke dhënë edhe mendime se si mund të zgjidhet problemi.

Është shumë e rëndësishme, po ashtu, që në ligjin zgjedhor, aq sa mundet ky ligj zgjedhor të veprojë, dhe për mendimin tim i ka shumë të ngushta hapësirat për të vepruar, të ndërhyhet për të zvogëluar, për ta parandaluar fenomenin që ka të bëjë me përdorimin e parave të pista, si mundësi për të blerë votat.

E fundit, për mendimin tim, nuk mjafton që gjithçka të trajtohet dhe vështirë se mund të zgjidhet brenda dhe vetëm në kuadrin e punës që bën Kuvendi i Shqipërisë për reformimin e Kodit Zgjedhor, por është shumë e rëndësishme që në të njëjtën kohë të punohet edhe me ligjet, të cilët interferojnë në Kodin Zgjedhor, siç është ai për gjendjen civile, ai për partitë politike dhe ky për dekriminalizimin, gjë që, të paktën në tryezën e fundit të organizuar nga

Këshilli i Europës për financimin e fushatave zgjedhore, nga bashkëkryetarët u tha se, po, është e nevojshme që të trajtohet një gjë e tillë. Pra, e mbështesim dhe këtu mund të japim ekspertizën dhe përvojën tonë se si mund të gjenden zgjidhje, të cilat të arrijnë të prodhojnë sinergjinë e ligjeve me njëri-tjetrin, duke synuar të njëjtin objektiv.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Kume!

Zoti Naço ka një pyetje.

Nasip Naço – Faleminderit të dy bashkëkryetarëve!

Unë do të doja t'i falënderoja të ftuarit për pjesëmarrjen dhe kontributin që kanë dhënë ndër vite, por edhe për aq sa dëgjuam ne sot. Në fund të fundit, partitë politike janë të stacionuara në llogoret e tyre dhe kanë nevojë për shoqërinë civile, kanë nevojë për Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe për një gjykim të ftohtë që u bëhet zgjedhjeve.

Pyetja ime lidhet me atë çfarë ndodhi në zgjedhjet e kaluara. Unë kam marrë mandatin në qarkun e Beratit dhe nuk e di nëse ju ka dalë në studimet tuaja dhe mund të bëni një sugjerim, pasi në qarkun e Beratit, pikërisht në Kuçovë, në mes të qershorit, Kryeministri i vendit Edi Rama u bëri thirrje mësuesve dhe i vuri në rresht që të merrte votat e tyre, por, edhe më keq, u kërkoi policëve që të hiqnin kapelat dhe të kërkonin votat, sepse i duhej të merrte numrin magjik 71. A keni menduar që këta nuk mund të përfshihen, por do të përfshihen oficerët, infermierët dhe mjekët, që janë të shoqërisë civile? A keni bërë ndonjë studim dhe a e keni denoncuar këtë si fakt në studimet tuaja? Dua mendimin tuaj nëse e keni në studim dhe nëse nuk e keni, a e keni parashikuar në të ardhmen që kryeministri i radhës mund të bëjë të njëjtën thirrje? Pavarësisht se Kryeministri e kuptoi gabimin dhe kërkoi falje. Thirrjen e bëri për të marrë votat dhe faljen e bëri nëpërmjet facebook. Faleminderit!

Bledar Çuçi – Mendoj se nuk është shumë relevante për të ftuarit sot, pasi ata nuk janë organet përgjegjëse që merren me zbatimin e Kodit Zgjedhor, sepse gjatë procesit zgjedhor, ata janë monitorues. Në lidhje me studimet, hulumtimet dhe kërkimet që ata kanë bërë, besoj se e dhanë përgjigjen më parë. Në qoftë doni të shtoni diçka tjetër në lidhje me atë çfarë tha zoti Naço, mund ta bëni.

Kristaq Kume – Ne kemi bërë një rekomandim, që gjatë fushatës zgjedhore, por edhe më parë, të mos bëhen inaugurime nga administrata publike apo nga qeveria.

Bledar Çuçi - Nëse nuk ka pyetje lidhur me atë çfarë tha zoti Kume, dua ta falënderoj atë, sepse është një nga kontribuuesit më të vjetër jo nga mosha, por nga eksperiencia në çështjet zgjedhore. Besoj se të gjitha ato që ai tha do të na i vërë në dispozicion edhe me shkrim, në mënyrë që të gjithë anëtarët të jenë të vëmendshëm dhe të

mbajnë shënime. Pasi përmendet të gjithë spektrin e procesit zgjedhor me rekomandimet që dhatë, nuk e di nëse keni ndonjë rekomandim apo opinion lidhur me votat e emigrantëve dhe mënyrën e votimit.

Nga takimet që janë bërë, unë e di që ju si institut keni një qëndrim për këtë dhe është e rëndësishme që këto opinione të na i vini në dispozicion për komisionin. Të gjitha sa thatë mendoj se janë shumë të vlefshme dhe prekin të gjithë spektrin e platformës që ne sapo miratuam në komision.

Po, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi - Gjithashtu më lejoni të falënderoj përfaqësuesit e tri organizatave për kontributin dhe gatishmërinë për të filluar këtë dialog me ju dhe me organizatat e tjera!

E mira e këtij aspekti është se nuk ka një monopol, në eksperiencën dhe dijen që është akumuluar në kohë. Ju keni një rol shumë të rëndësishëm, duke filluar me organizatën më të vjetër të vëzhgimit të zgjedhjeve, siç ka qenë SHKD-ja, me rolin e hershëm të zotit Kume, si një organizim ombrellë për vëzhgimin e zgjedhjeve që në vitin 2003, si dhe rolin e madh që ka luajtur Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Ju falënderoj për propozimet tuaj! Ne presim ende prej jush që të na sillni material të strukturuar dhe të konsoliduar.

Këtu po e mbyllim mbledhjen. Lajmi kryesor i kësaj mbledhjeje ishte fakti që ky komision miratoi programin e punës dhe grupin ekspertëve.

Nga ky moment, komisioni do të fillojë të ndjekë linjat që përcaktoi me intensitet në mënyrë që të arrijmë në draftimin e zgjedhjeve konkrete dhe ta fusim në kohë në Kodin Zgjedhor para zgjedhjeve të ardhshme.

Të nderuar kolegë, faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA